VENDIM
Nr.1535, datë 26.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.378, DATË 12.8.1999 TË KËSHILLLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, të neneve 13 e 15 shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2003 "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 8/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e objekteve, që i bashkëlidhet vendimit nr.378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqen pasuritë, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Pasuritë e mësipërme transferohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E OBJEKTEVE TË CILAVE U HIQET E DREJTA E PRONËSISË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE

1. Metalike Tirana, Laprakë Tiranë	sipërfaqe prej 13 000 m^2
2. Metalike Tirana, Tiranë (reparti i orëve)	sipërfaqe prej 418 m^2
3. Ofiçina e automjeteve, Tiranë	sipërfaqe prej 14 502 m^2
4. Uzina e pjesëve të ndërrimit të automjeteve, Tiranë	sipërfaqe prej 15 000 m^2
5. Uzina e remontit të makinave metalprerëse, Tiranë	sipërfaqe prej 17 850 m^2
6. Uzina mekanike, Tiranë	sipërfaqe prej 10 623 m^2
7. Rërë shtufi, Tiranë	sipërfaqe prej 11 863 m^2
8. Parku i transportit, Tiranë	sipërfaqe prej 33 771 m^2